

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Haxhiu: Lajm tronditës për Kosovën, aktgjykimet nuk e rishkruajnë dot hi storinë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/denimi-i-ish-krereve-te-uck-se-haxhiu-lajm-trondites-per-kosoven-akt-gjykimet-nuk-e-rishkruajne-dot-historine/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:37:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:33:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f61ae94ce6ad42ef869adb4447342f46e9278a8120282a8d5afb68af7940c070
TEKSTI	970793f3eac5d1db8dad021bf7f7dffc8c33bb16ff599346745a250f9fb18d7
PAMJA	5f43736f8fb9c9fc92b791e1bdd240623cada4c3328994d18e3ace324b3c95ba

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	58ca508604bd1d63ba185de23e5ac74aea28aa011ef96e70391ef7e78715390c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1f56947d1ce9865195ccff7ffa5c5fdb522467bfff0934ba4720654b865868030
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/58ca508604bd1d63ba185de23e5ac74aea28aa011ef96e70391ef7e78715390c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK SHBA Edi Rama Giorgos Mazonakis Rexhep Selimi

KOSOVË | RAJONI

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Haxhiu: Lajm tronditës për Kosovën, aktgjykimet nuk e rishkruajnë dot historinë

16 Shtator 2026 | 12:33

Presidentja në detyrë, Albulena Haxhiu, e ka cilësuar si lajm tronditës për Republikën vendimin e Gjykatës Speciale për dënimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte.

Haxhiu i është drejtuar me mesazh të dënuarve, duke u thënë të qëndrojnë të fortë sepse Kosova është me ta.

"Aktgjykimi i sotëm dhe dënimet e shqiptuara ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit janë një goditje e rëndë për familjet e tyre, një lajm thellësisht tronditës për Republikën e Kosovës dhe një çast i rëndë për kombin shqiptar kudo që jeton.

Në një ditë si kjo, pesha e këtij vendimi nuk mund të ndahet nga historia prej së cilës kemi ardhur. Kosova e ka përjetuar mbi vete dhunën e një aparati shtetëror që vrau civilë, kreu masakra, dëboi qindra mijëra shqiptarë nga shtëpitë e tyre dhe la pas mijëra të vrarë e të zhdukur. Kjo përvojë është pjesë e pashlyeshme e kujtesës së Kosovës dhe të kombit shqiptar.

Mendimet e mia janë, para së gjithash, me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Prej vitesh ato mbajnë barrën e mungesës, pritjes dhe pasigurisë. Dënimet e sotme e bëjnë këtë barrë edhe më të rëndë.

Atyre ua përcjell nga Kosova një porosi, qëndroni të fortë, Kosova është me ju. Fjala e fundit juridike nuk është thënë. E drejta e ankimit është pjesë e procesit dhe duhet të ushtrohet plotësisht.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte çlirimtare. Ajo lindi përballë shtypjes, dhunës dhe krimeve të regjimit të Serbisë ndaj popullit të Kosovës. Asnjë aktgjykim nuk mund ta ndryshojë natyrën e asaj lufte dhe as të zhbëjë të drejtën e një populli për të luftuar për lirinë e vet.

Respekti për drejtësinë nuk nënkupton heshtje përballë çdo përpjekjeje për ta shtrembëruar historinë. Nuk duhet lejuar që dënimet e sotme të përdoren për të relativizuar krimet e regjimit të Serbisë, për ta zvogëluar përgjegjësinë për to apo për të krijuar një narrativë të re.

Këtë qartësi e presim edhe nga miqtë dhe aleatët tanë.

LAJMI I FUNDIT

12:28 Vdekja e këngëtarit Giorgos Mazonakis, Prokurorët urdhërojnë hetim të ri për klinikën në Athinë

12:24 Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagojnë kryetarët e Grupit Parlamentar të PS dhe PD: Padrejtësi

12:14 Dënimi i ish-krerëve të UÇK, Haradinaj: Vendim i padrejtë, kjo betejë duhet të fitohet në shkallën e dytë

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

12:06 Dënimi me 25 vjet burgim për Hashim Thaçin, vëllai i ish-presidentit: Jemi të bindur në pafajësi, presim Apelin

12:01 25 vite burg për Jakup Krasniqin, reagon vajza e tij: Ndodhi padrejtësia më e madhe e këtij shekulli

11:45 Rexhep Selimi dënohet nga Haga me 13 vite burgim

TESTIM

Sot na duhet qetësi, dinjitet dhe bashkim. Dhimbja e kësaj dite nuk duhet të na ndajë.

Republika e Kosovës do ta përballojë edhe këtë sprovë duke i qëndruar besnike drejtësisë, lirisë dhe së vërtetës së saj. Sepse aktgjykimet nuk mund ta gjykojnë historinë e një populli as nuk mund ta rishkruajnë atë", ka shkruar ajo.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagojnë kryetarët e Grupit Parlamentar të PS dhe PD: Padrejtësi

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë lidhur me ish-drejtnesit e Ushtrisë Çlirimtare të...

12:24 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

Dënimi i ish-krerëve të UÇK, Haradinaj: Vendim i padrejtë, kjo betejë duhet të fitohet në shkallën e dytë

Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka reaguar këtë të mërkurë përmes një video në rrjetet sociale lidhur me dënimin e ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata...

12:14 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

Dënimi me 25 vjet burgim për Hashim Thaçin, vëllai i ish-presidentit: Jemi të bindur në pafajësi, presim Apelin

Gani Thaçi, vëllai i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguar pas dënimit të tij me 25 vjet burgim nga Dhoma e Specializuar të Kosovës...

12:06 | 16/09/2026

TEMA

Vendi

Rajoni

SHËRBIME

Live

Lajmi fundit

KOMPANIA

Rreth Euronews

Kushtet e përdorimit

[Bota](#)
[Video](#)

[Na ndiqni](#)
[Euronews Radio](#)
[Për persona me aftësi të kufizuara](#)

[Politika e cookie](#)
[Kontakttoni](#)

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.